

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
NJËSIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mall

**“PËR MIRATIMIN DHE ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
TË KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE LETËR A4”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CVP):

LETËR PËR PRINTIM 30197630-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.666.476 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 82 dhe 83 të LLP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenet 14/1, 14/2, 25, 26 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

a. .Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cileneshte e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi:Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kriteret e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LLP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 41, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 1/b dhe pika 3, e LPP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesa të cilat garantojnë se operatorët ekonomik pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën si dhe në nenin 43 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon një kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”* Gjithashtu në përputhje me nenin 55, pika 4, paragrafi 1 dhe 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”* Vendosja e këtij kriteri kaulifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e detyrimeve vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

Argumentimi: Në lidhje me Vërtetimin për likuidimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, kërkesa e mësipërme është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i dryshuar dhe në përputhje me nenin 76, pika 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023, sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht me Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subkjektet që ushtrojnë veprimtari tregtare, kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur sipas përcaktimeve bazuar në nenin 77, pika 4., të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe të nenit 40, pika 4 dhe nenit 55, pika 4/b., të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, pasi është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesat të cilat garantojnë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për ta zbatuar kontratën.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor janë kërkuar vërtetimin për realizimin e kontratave të ngjashme në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur për të vërtetuar që ofertuesi/ofertuesit pjesëmarrës ka/kanë përvojën e duhur, ka/kanë kapacitetet e duhuara si teknike dhe organizative për të realizuar një kontratë të tillë. Paraqitja e vërtetimit për realizimin me sukses të kontratave të ngjashme nga ana e Operatorit Ekonomik dëshmon me korrëktësi në përmbushjen me sukses të detyrimeve kontraktore të Operatorit Ekonomik në raste të tjera të ngjashme si në cilësi ashtu dhe në afatet duke krijuar besueshmëri te Autoriteti Kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës.

Në bazë të këtij kriteri operatorët ekonomik vërtetojnë eksperiencën në fushën objekt prokurimi dhe autoriteti kontraktor merr garancinë e nevojshme që furnizimi do të kryhet me sukses. Përvoja e operatorit ekonomik është një element shumë i nevojshëm për autoritetin kontraktor për të vërtetuar qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmëria në përmbushjen e suksesshme të kontratës. Për kontratat e realizuara nga operatori ekonomik, operatori duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar

me qëllim ti shërbej autoritetit në vlerësimin sa më të qartë të kriterit për eksperiencat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogë/broshurë/skeda teknike nën autoritetin e prodhuesit në të cilin të gjejnë pasqyrim specifikimet teknike të kërkuara në DST me qëllim që AK të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. (Katalogjet /broshurat/skedat teknike të përkthyer në gjuhën shqipe).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokument zyrtar nën autoritetin e prodhuesit me anë të të cilit të vërtetohet që letra e ofertuar plotëson standardin ISO 9706:2002. (Dokumenti i paraqitur duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe).

Argumentim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36, të pikës 4, të nenit të 77, nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknik dhe i plotësojnë kërkesat e cilësisë, të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një mostër fizike (rizëm) që kërkohen të prokurohen, të përcaktuar në DST në përputhje me specifikimet teknike.

Mostra duhet të paraqitet në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me adrese: Rruga e Kavajës, Ndërtesa Nr. 205, 1023, Tiranë.

Shënim: Mosparaqitja e mostrës, dorazi, në ditën e hapjes së ofertave është kusht s’kualifikues.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 40, pika 6, gërma a), e V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku shprehimisht thuhet se: *“Autoriteti/enti kontraktor mundt t’u kërkojë operatorëve ekonomik të dorzojnë dëshmi, që tregojnë se ata plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, si:*

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen

në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë (nëpërmjet një **deklarate konformiteti**), se malli që do të dorezojë:

- Do të jenë të njëjtë me mostrën fizike të paraqitur ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Të paraqesë një deklaratë ku të specifikohet, që operatori ekonomik merr përsipër transportin e mallit në çdo kohë drejt ambjenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me me nenin 40, pika 8 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku shprehimisht thuhet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e mallit që prokurohet. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 1, të nenit 79, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit si dhe referuar nenit 44 pika 1., të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga

Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.” Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilësisë”.

Përbushja e standardeve ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë. Autoriteti ka vendosur si kriter kualifikues kriterin e mësipërm pasi ky kriter jep sigurinë autoritetit që operatori ekonomik fitues do përbushë kërkesat për realizimin me sukses të kontratës së shpallur, është përcaktuar ISO 9001:2015, e cila përcakton kriteret për një sistem të menaxhimit të cilësisë dhe mund të përdoret nga çdo organizatë, e madhe apo e vogël pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

Specifikime Teknike:

Specifikimet teknike letrës dhe parametrat teknik të saj, janë si mëposhtë:

Letër format A4:

- Përmasat e letrës të jenë 210 x 297 mm;
- 1 (një) rizëm të përmbajë 500 (pesëqind) fletë A4;
- Letra të jetë ngjyrë e bardhë absolute në mënyrë që të ketë kontrast në printim dhe në fotokopjim;
- Peshë e një flete A4 të jetë 80 gram/m²;
- Cilësi “anti-curl” që redukton bllokimet e letrës në paisje;
- Sipërfaqe e lëmuar;
- Përdorimi: Për printim dhe fotokopjim;
- Dukshmëria: > 94 %
- Shkëlqimi: nga 95 deri në 110 %;
- Letra të qëndroj e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit;
- Të jetë e përshtatshme për printim nga të dyja krahët e letrës;
- Të plotësoj standardet që letra të mbahet për një periudhë kohore jo më pak se 5 vjet në arkivë;
- Të mos jetë letër e ricikluar;
- Amballazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës në kuti me kapacitet 5 (pesë) rizma.

Në rast të mosplotësimit të njëres nga kushtet/specifikimeve teknike të vendosura mësipër, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të anuluar kontratën/s’kualifikuar operatorin ekonomik në çdo moment.

Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP, për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt